REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

TETOR 2026

BULETINI MUJOR

MINISTRIA E MJEDISIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Prezantohet "Pasqyra e Flamingos"

Kjo platformë i jep publikut akses në dokumentet dhe procedurat institucionale për dy iniciativat në Sazan dhe Zvërnec. Dokumentet janë pasqyruar në rend kronologjik, së bashku me kompetencat e secilit institucion dhe sqarimet ligjore për pyetjet e ngritura në diskutimin publik.





Ministri Jaupaj firmos protokollin e bashkëpunimit me Agjencinë Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit

Përmes projektit "Albania Air Quality Alignment", në partneritet me Agjencinë Suedeze për Mbrojtjen e Mjedisit, synojmë të forcojmë monitorimin e cilësisë së ajrit, sistemet e të dhënave mjedisore dhe kapacitetet institucionale.

Nënshkruhet memorandum mes Ministrisë së Mjedisit dhe Albanian ESG Network

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Ministrisë së Mjedisit dhe Albanian ESG Network krijon një kornizë konkrete bashkëpunimi për të mbështetur bizneset shqiptare në përgatitjen për standardet e qëndrueshmërisë të tregut europian. Standardet europiane janë pasaporta drejt një tregu me mbi 400 milionë konsumatorë, dhe kompanitë që përgatiten sot do të jenë ato që udhëheqin nesër.



BULETINI
MUJOR
TETOR 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT



Përmbyllet projekti “Krijimi i një modeli menaxhimi për luftimin e sëmundjes së procesionares”

Projekti, me financim nga IADSA prej rreth 363,000 eurosh dhe bashkëfinancim prej 44,000 eurosh, u zbatua nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve, në bashkëpunim me Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Qendrën ISHEP. Në kuadër të tij u ngritën tre laboratorë në Fushë-Arrëz, Bulqizë dhe Gjinar, si dhe një laborator pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Miratohen ndryshimet në ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”

Ndryshimet kanë në fokus forcimin e mekanizmave për restaurimin e natyrës, mbrojtjen e biodiversitetit, nxitjen e investimeve të gjelbra dhe funksionalizimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit. Këto ndryshime synojnë të mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm, të përmirësojnë instrumentet e financimit për mbrojtjen e mjedisit dhe të avancojnë përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Publikohet për Konsultim Publik Projektvendimi për Certifikimin e Ekspertëve Mjedisorë

Konsultim publik i projektvendimit "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Korpusi i Gjelbër Shqiptar

Klasa e Gjelbër, programi që edukon brezin e ri për mbrojtjen e natyrës!

Gjatë javës së parë të tetorit, rreth 500 nxënës u përfshinë në aktivitete kushtuar Ditës Botërore të Kafshëve, Ditës Botërore të Habitateve dhe Ditës së Mbrojtjes së Dinarideve. Në total, programi ka përfshirë mbi 2000 nxënës, duke nxitur angazhimin e të rinjve për mbrojtjen e natyrës.

BULETINI
MUJOR
TETOR 2026